



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 504/2 Prot.

Tiranë, më 20.03.2024

VENDIM

Nr. 2, datë 20.03.2024

Bazuar në ligjin nr. 17/2018 "Për statistikën zyrtare", neni 26, shkronja ë), me propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 18.03.2024

VENDOSI:

Në Rregulloren e Bordit Drejtues të 2018, të ndryshuar me Vendimin nr. 1174/22, datë 01.02.2019, të Bordit Drejtues të INSTAT, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nenin 9 pika 1, pas fjalës "paraparak" shtohen fjalët "Sekretariati, dhe për dijen".
2. Në nenin 10 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në pikën 1, pas fjalës "Drejtues" shtohen fjalët "përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ngrihet".
 - b) Në fund të fjalës së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:
"Njëri nga anëtarët e Sekretariatit duhet të jetë jurist".
 - c) Pika 4 ndryshohet me këtë përmbajtje:
"Sekretariati i Bordit harton listë-prezencën e cila duhet të firmoset nga anëtarët e Bordit dhe personat të tjerë të pranishëm në fund të mbledhjes."
 - d) Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:
"Në rastet kur anëtarët dhe persona të tjerë ose një pjesë e tyre janë të pranishëm on-line, atëherë listëprezencë për këta nënshkruhet nga Sekretariati, duke reflektuar përbri çdo emri të anëtarit ose personi tjetër fjalën "on-line".
 - e) Në pikën 5 pas fjalës "anëtarëve" shtohen fjalët "sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 35".
 - f) Në pikën 6, fjalia "kujdeset" zëvendësohet me fjalët "është përgjegjës";
 - g) Pas pikës 6 shtohen pikat 7, 8 dhe 9 me këtë përmbajtje:
"7. Sekretariati është përgjegjës për publikimin e vendimeve të Bordit në faqen web të INSTAT.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: +355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

8. Juristi i Sekretariatit koncepton vendimet e Bordit jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes nga të gjithë anëtarët e Bordit të pranishëm në mbledhje.

9. Njëri nga anëtarët e Sekretariatit caktohet nga Kryetari për kryerjen e regjistrimit audio të mbledhjes, sipas pikës 6 të nenit 31 të kësaj rregulloreje”.

3. Në nenin 18 bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 2 në shkronjën c) pas fjalës “strategji” shtohet fjala “sektoriale” dhe shkronja d) shfuqizohet.
- b) Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:
 - i) shkronja b) shfuqizohet;
 - ii) shkronja c) ndryshohet me shkronjën ç) dhe shkronja ç) zëvendësohet me shkronjën c) pa ndryshuar përmbajtjen e tekstit.
 - i) shkronja dh) ndryshohet me këtë përmbajtje:
“Udhëzime dhe procedurat në funksion të standardizimit të veprimtarisë së INSTAT.”;
 - ii) shkronja e) shfuqizohet;

4. Në nenin 22 në pikën 1 fjalët “e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me fjalët “përgjegjëse për financa”.

5. Në nenin 23 pika 3 shkronja b) shtohet nënpika v) me këtë përmbajtje:

“v) të propozojë planin për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga shërbimet statistikore për të tretët.”

6. Në nenin 24 në pikën 1, numri “23” zëvendësohet me “24”

7. Në nenin 25 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Anëtari i Bordit, Nëpunës Zbatues, i paraqet anëtarëve të tjerë të Bordit pasqyrën e të ardhurave të krijuara dhe/ose të planifikuara për tu krijuar gjatë vitit përkatës kalendarik, brenda datës 15 Shtator.”

b) Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“2. Anëtarët e Bordit hartojnë jo më vonë se data 01 Tetor, propozimet për shpërndarjen e të ardhurave të krijuara nga të tretët në përputhje me parashikimet e neneve 35, 36 dhe 37 të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, VKM nr. 393, datë 19.06.2019 “Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara” dhe Udhëzimit të Përbashkët ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave nr. 1310/2 prot., datë 24.09.2020 “Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimeve statistikore që kryen INSTAT ndaj të tretëve”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta”, Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- c) Pas pikës 2 shtohen pikat 3 dhe 4 me këtë përmbajtje:
"3. Mbledhja e Bordit për shpërndarjen e të ardhurave organizohet jo më vonë se data 31 Tetor.
- 4. Vendimi i Bordit sipas këtij neni ekzekutohet nga INSTAT-i brenda muajit dhjetor të vitit të vendimit."*
8. Në nenin 26 pika 1 shkronja a) fjala "ngritjen" zëvendësohet me fjalën "funksionimin".
9. Në nenin 27 bëhen këto ndryshime:
- a) Titulli nenit ndryshon me këtë përmbajtje:
"Plani për funksionimin e sistemit të MFK dhe menaxhimit të riskut (MR)"
- b) Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:
- i) Fjala "ngritjen" zëvendësohet me fjalën "funksionimin";
- ii) Fjalët "të paktën një herë në vit" zëvendësohen me fjalët "brenda muajit dhjetor për vitin pasardhës";
- iii) Pas shkronjës a) shtohet shkronja a/1) me këtë përmbajtje:
"Raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin"
10. Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:
- a) Në titullin e nenit fjala "miratim" zëvendësohet me fjalën "Diskutim";
- b) Në pikën 1 numri "25" zëvendësohet me numrin "27";
- c) Në pikën 5 fjalët "Plani i" zëvendësohen me fjalët "Mendimet për".
11. Në nenin 31 pas pikës 4 shtohen pikat 5 dhe 6 me këtë përmbajtje:
- "5. Në raste të jashtëzakonshme ose në kushtet e pamundësisë së pranishme fizike, Kryetari vendos që mbledhjet të zhvillohen online nëpërmjet platformës së organizimit të mbledhjeve online/hibride, linku i të cilës u komunikohet anëtarëve të Bordit nga Sekretariati jo më vonë se 3 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.*
- 6. Në rast se gjykohej e arsyeshme, Kryetari vendos regjistrimin audio të mbledhjes, duke njoftuar paraprakisht të gjithë anëtarët e Bordit dhe Sekretariatit. Regjistrimi Audio administrohet nga anëtari i Sekretariatit, i ngarkuar të kryejë regjistrimin, dhe asgjësohet menjëherë pas finalizimit dhe nënshkrimit të procesverbalit të mbledhjes. Anëtari i Sekretariatit që ka kryer regjistrimin audio të mbledhjes mban përgjegjësi ligjore për ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit audio të regjistruar."*
12. Neni 34 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: +355 (4) 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

- a) Në pikën 1, Numri "3" zëvendësohet me numrin dhe fjalën "2 (dy)" dhe pas fjalës "data" shtohen fjalët "nënshkrimit të procesverbalit të";
b) Në pikën 2 pas fjalës "mbledhje" shtohen fjalët "fizikisht dhe/ose online".

13. Në nenin 35 bëhen këto shtesa:

- a) Në pikën 1, Pas fjalës "anëtar" shtohen fjalët "persona të tjerë të thirrur apo të ftuar".

- b) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1 Nëse nga anëtarët ka kundërshtime për përmbledhjen e diskutimeve përkatëse të tyre, duhet të njoftojnë Kryetarin e Bordit duke treguar njëkohësisht edhe pasaktësitë konkrete që vlerësojnë se përmban përmbledhja e diskutimit të tyre. Kryetari i Bordit urdhëron menjëherë ballafaqimin e përmbledhjes me kundërshtimet, (dhe regjistrimin audio nëse ka) si edhe ndryshimin e procesverbalit, në qoftë se vërejtja për pasaktësi në përmbledhjen e diskutimit përkatës rezulton e justifikuar."

14. Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

- a) Pika 1 ndryshon me këtë përmbajtje :

"1. Vendimet e Bordit zbardhen nga Sekretariati brenda 2 (dy) ditëve nga data e nënshkrimit të procesverbalit të mbledhje, nënshkruhen nga Kryetari dhe Sekretariati dhe depozitohen në protokollin e INSTAT-it."

- b) Pika 4 ndryshon me këtë përmbajtje:

"4. Vendimet e Bordit pas nënshkrimit nga Kryetari i Bordit bëhen publike në faqen zyrtare të INSTAT-it."

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHEULI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta", Nd. 35, H. 1, Njesia Administrative N. 2, Tirana, Shqipëri
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al